



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 30

Datë: 15. 06. 2017, ora: 14:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 23, 24, 25/2017
2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;
3. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)
4. Të ndryshme

1. Hyrje: Mbledhja është kryesuar nga znj. Valdete Daka, kryetare e KQZ

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 23, 24, 25/2017

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 30 të KQZ-së! A ka dikush propozime për rendin e ditës? Vërejtje? Nëse jo, kush është për këtë rend dite? Faleminderit!

- **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 24 dhe 25**

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën e parë. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 24 dhe 25. A ka dikush vërejte në këto procesverbale? Nëse jo kush është për? Faleminderit!

Komisioni miratoi unanimitet procesverbalet e mbledhjeve 24 dhe 25

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhorë

Valdete Daka: Vazhdojmë me aktivitetet e sekretariatit lidhur me procesin zgjedhorë. Urdhëro, kryeshef!

Enis Halimi: Faleminderit! Të nderuar anëtarë, te nderuar pjesëmarrës, para vetës keni një raport përmbledhës, ndoshta jo përfundimtarë, të gjithë aktivitetit që është zhvilluar gjatë procesit zgjedhorë, por një pjesë që përfshinë nga dita e zgjedhjeve dhe pas kësaj dite. Sa i takon çështjes së zarfeve, përkatësisht pakove të fletëvotimeve që kanë ardhur nga jashtë, vlerësimi i këtyre pakove ka filluar në ditën e zgjedhjeve. Pra, me datën 11 dhe ka përfunduar me datën 14 qershor. Pas vlerësimit të pakove është bërë klasifikimi i pakove me kutitë e votimit të cilat janë identifikuar me kode të sigurisë dhe nën përkujdesjen e masave të sigurisë janë përcjellë për në QNR. Divizioni i shërbimit votues para periudhës së shërbimit përmes postës ka dërguar 1919 pako përmes postës, dhe ka bërë njoftimin përmes e-mailit të gjithë votuesve jashtë Kosovës të cilëve i është aprovuar suksesshëm përgjatë periudhës të aplikimit për regjistrim.

Deri me datën 9 qershor 2017, tha z. Halimi, përmes postës janë pranuar 3573 pako të supozuara me fletëvotime. Them të supozuara për shkak se këto si të tilla, si zarfe, si pako nuk janë hapur. Pra supozojmë që ato mund të ketë, dhe do të ketë fletëvotime. Gjithashtu janë pranuar komfor vendimeve adekuate që janë marrë me datën 11, janë pranuar për procedim edhe 1001 pako të supozuara me fletëvotime. Numri total i pakove me fletëvotime të cilat janë pranuar përmes postës është 4574. Po ashtu divizioni përkatës ka filluar vlerësimin e këtyre pakove, vlerësimi i pakove bëhet me qëllim të identifikimit të fletëvotimit të personit që ka dërguar pakon në fletëvotim

Betim Gjoshi: Faleminderit Kryetare. Të faleminderit kryeshef për raportin unë mendoj që brenda 30 ditëve që keni pasur kompetencë keni marrë veprime të mira. Sa i përket realizimit procesit zgjedhor komfort standardit është mirë që e keni një vlerësim preliminar procesi zgjedhor ka shkuar mirë por kjo nuk na jep asnjë arsye të kënaqemi me punën që kemi bërë. Unë mendoj që gjatë këtyre ditëve është mirë që të përgatisim një takim ku të analizojmë gjitha gjetjet apo të analizojmë procesin zgjedhor me qëllim që neve na pret një cikël tjetër zgjedhor, eventualisht të gjitha të metat që mund të jetë në këtë proces ti kemi parasysh sidomos edhe pjesën e rekomandimeve të raportit preliminar vëzhguesve të Bashkimit Evropian. Për mu si anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor mendoj që me atë që kam parë deri me tani problemi më i madh që na ka përcjell ka qenë numri i madh i fletëvotimeve të pa vlefshme që historikisht me

shikuar ka qenë në zgjedhje nacionale ka qen numri më i madhi ndoshta krahasuar me zgjedhjet 2010 apo mund të jetë edhe trefishi i tyre është mirë po ashtu kemi numër te fletëvotime edhe me kusht. Është mirë qe gjatë procedurave në QNR që keni, sidomos rastet kur ka rinumërimë është mirë që ti merrni për baze dhe të bëni një analizë me mostra apo siç ju vendosni me shikuar se cilat janë arsyet që ka ardhur deri te kjo.

Ne, tha z. Gjoshi, edhe në të kaluarën kemi bërë analizë, mundë të kem mendimin tim se si jon arsyet se kjo ka ndodhë...Mirë është që ju të bëni një analizë ta kemi të saktë edhe të veprojmë të marrim masa në atë drejtim. Qe ka të bëjë me edukimin e votuesve atëherë është detyrë e jona kushtetuese, ligjore që ta bëjmë këtë punë. Edhe është mirë që të marrim aktivitete, pra mendoj që në këto të meta ku kemi pas të bëjmë një analizë. Është mirë të bëjmë një analizë, është mirë që në bashkëpunim me Komisionet Komunale Zgjedhore me alokime manualisht votuesit më mirë kemi pasur jashtë zakonisht vërejtje të mëdha për ndërrim të qendrave të votimit të votuesve. Kjo vlen sa i përket votave me kusht edhe pse kemi marr masat. Edhe në të kaluarën këto kishin me qenë fillimisht disa nga sugjerimet e miya pa dashur, se për pjesën e mirë dhe kemi kohë t'ia themi herëve tjera pa dashur t'i adresojmë kritika sot. Është mirë që ju t'i analizoni pastaj, në bazë të tyre të jepni secili vlerësimet tona edhe ju kisha lutë që mos të nguteni të jepni vlerësime pa i analizuar gjërat për problematika të caktuara në të cilat, po i shohim këtyre ditëve në media.

Në fund, tha z. Gjoshi, është mirë të mbajmë mbledhje pak më shpesh ma shumë që mos të grumbullohen me pika të rendit të ditës apo vendime të caktuara se juve ja lehtësojnë punën që të vijnë tek certifikimi i rezultateve në kohë sa më rekorde për aq sa varet nga ne kuptohet që shumica varet prej ligjit dhe procedurave që ka të bëjë me ankesat ju faleminderit.

Valdete Daka: Po Adnan.

Adnan Rrustemi:Faleminderit. Shpresoj që sekretariati në ditët në vijmë do ta përgatitë një raport përmbledhës për gjithë procesin e ecurisë nga fillim përgatitjet dhe mbarëvajtja e ditës së zgjedhjeve natyrisht duke marrë parasysh për bazë gjetjet e rekomandimit te raportit preliminar. Por, veçanërisht te raporti përfundimtarë të vëzhguesve ndërkombëtar e vendor e sidomos atyre ndërkombëtar. Megjithatë tani për tani, unë kërkoj prej sekretariatit që të përqendroj vëmendjen dhe energjinë dhe kapacitetet në proceset që janë në vijim e sipër, sidomos në aktivitetet në QNR, që të përmbushen me profesionalizëm dhe me transparencë, dhe të sigurohet që të përmbillet si proces sa më parë dhe KQZ ta përmbyllë detyrimin e saj për ti shpallur dhe certifikuar rezultatet natyrisht. Megjithatë në vazhden e raportit, kështu si informacion fillestarë në ditët në vijim mbase mund ta kemi një informacion për votimin jashtë vendit.

Konkretisht, tha z.Rrustemi, po e shohim që ka përkundër vështirësive për regjistrim dhe numrit të vogël kemi një numër shumë më të vogël të pakove të dërguara. Nga 15,000 votues që janë regjistruar kemi vetëm afërsisht 5,000 që nënkupton 25% afërsisht të totalit. Ndoshta në këto ditë mund të pranoni në fanë postarë ende zarfe mund të arrijnë. E kuptoj që ato nuk mund të procedohen tashmë sepse procesi është përmbyllur, por si informacion në aspektin statistikorë

vlen që t'i kemi si informacion. A kanë vazhduar me ardhur? A bëhet fjalë edhe për faktin që edhe periudhë ka qenë e shkurtër, që të mos arrihen që të mos procedohen si të tillë?

Vladete Daka:Urdhëro, kryeshef!

Enis Halimi: Nuk është se nuk kemi menduar për një reflektim për këtë proces zgjedhorë për të nxjerrë mësimë që do të na shërbejnë shpejt në zgjedhjet lokale. Jemi duke menduar që të gjejmë një mëso-kohë që ta realizojmë edhe atë si aktivitet, ndoshta me gjithë, ashtu sikundër kemi pasur edhe një lloj tradite, por edhe që pas zgjedhjeve të organizohet një takim i tillë. Megjithatë jemi duke shikuar dhe shfrytëzuar energjitë tona, sepse për ne ende procesi nuk ka përfunduar. Pra, po e shikojmë që të jemi shumë efikas në procedimin dhe përmbushjen e obligimeve tona. Për sa i takon çështjes që lidhet me këtë, ne sa do që kemi pasur afatin e shkurtër për votimin jashtë vendit, i kemi referuar gjithmonë që, kemi aplikuar një qasje afirmative, pra kemi shkuar edhe njoftimin për regjistrim dhe ftesën që e kemi dërguar.

Sado që e kemi pasur afatin e shkurtër, tha z. Halimi, nuk e kemi dërguar në postë, e kemi dërguar në qendrën e distribucionit në mënyrë që të kapim afate sa më të shpejta, në mënyrë që t'i mundësojmë sa më shumë votuesve që të marrin pjesë në procesin zgjedhorë. Po ashtu, kemi qenë në kontakt, jo vetëm me postën por edhe me qendrën e distribucionit në pranimin e këtyre materialeve me qëllimin që të kemi sa më shumë. Po ashtu do të kontaktojmë me postën për të kontrolluar edhe një herë. Jemi duke punuar me të gjitha energjitë e tona në fazën e procesit zgjedhorë, të koncentruar aty ku është më aktual në QNR.

Valdete Daka: Faleminderit, krye shef! Nëse nuk kemi diçka tjetër lidhur me këtë pikë vazhdojmë me pikën tjetër. Ajo është raporti nga QNR.

3. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

Enis Halimi: Faleminderit! Materialin e keni marrë nga sekretariati, përkatësisht nga njësia e QNR-së. Edhe më herët kemi pasur raporte informuese përmes e-mailit për rrjedhën e materialit, për kohën e ardhjes së tyre, numërimin e kështu me radhë. Gjatë pranimit janë evidentuar 125 votime të dyfishta të cilat nuk kanë mundur të procedohen si të rregullta dhe si të tilla janë vendosur në karantinë. Votues të aprovuar në postë janë 5246. Gjatë pranimit të materialit të ndjeshëm një numër i vendvotimeve nuk ka mundur të pranohen si të rregullta, ndërsa nuk janë respektuar deri në fund proceduar e pranim dorëzimit nëpër KKZ. Rastet me të shpeshta i keni të grumbulluara, sikur janë ndryshimi i shiritave. Rastet me të shpeshta janë evidentuar gjatë pranimit të materialit të ndjeshëm, mosrespektimi i procedurës për ndërrim të shiritave. Janë disa raste ku ka munguar lista përfundimtare e votuesve, formulari i rezultateve të kandidatëve, ka munguar libri i votimit. Formularët e rezultateve FFR dhe FRK nuk janë nënshkruar nga anëtarët e këshillit. Nuk janë plotësuar formularët e rezultateve në disa raste, në disa raste është plotësuar FFR ndërsa FRK jo. Futja e të dhënave nga formularët e rezultateve FFR dhe FRK, si dhe skanimi i listave përfundimtare të votuesve është duke u proceduar. Tashmë ka përfunduar si proces, përjashtoj këtu formularët që janë në kutitë në karantinë. Ndërkohë që procedohen formularët e rezultateve në futjen e të dhënave, një numri i vendvotimeve nuk mund të

procedohen pasi tejkalojnë nivelin e tolerancës dhe si të tilla jemi të detyruar t'i procedojmë në auditiv me qëllim të qartësimit të gjitha situatave që kanë sjellë një gjendje të tillë. Rastet më të shpeshta që po dërgohen në auditiv janë kur subjekti politik nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, kandidatët kanë më shumë vota se subjektet. Janë evidente edhe rastet kur ka shkarje në kuptimin teknik të fjalës, ka ngatërrim të rubrikave, por këto sipas procedurave të Qendrës së Numërimit të Votave janë raste ku mund të përmirësohen.

Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve, është në proces të skanimit të listave përfundimtare të votuesve, po ashtu po sa të përfundoj procesi i skanimit lista përfundimtare e votuesve do të sigurohemi me regjistrimin e votuesve me kusht dhe pas një kontrole të kryqëzuar që bëhet do të filloj edhe valudimi i këtyre votave me kusht, dhe pastaj edhe procedimi i këtyre për numërim pra pas procesit të valudimit që përfshin procesin e kontrollimit të ashtuquajturës të kryqëzuar. Qendra e Numërimit siç mund ta dini është duke punuar në tri ndërrime, 24 orë në mënyrë që të kemi sa më të shpejt procedimin e të dhënave, pra me formular të rezultateve, editimin, numërimin e votave me kusht, votat nga personat me aftësi të veçanta, votave me post dhe ndonjë rinumërim eventual. Për këtë mbledhje kemi përgatitur disa rekomandime, bazuar në gjetjet që kemi pasur gjatë hulumtimit dhe analizimit të këtij materiali që ka arritur në Qendrën e Numërimit të Rezultateve cilat do ti lexoj si në vijim. Janë disa raste si në vijim ku kategoria e parë është ku mungon libri i votimit në disa vendvotime mungon libri i votimit ndërkaq gjatë hetimit të këtyre rasteve QNR-ja ka gjetur, përtej kësaj që mungon libri i votimit, materialet e tjera kanë qenë në korrekt dhe mbi bazën e kësaj analize këtij hetimi që ne kemi bërë rekomandohet KQZ që materiale nga këto vendvotime ti aprovoj si të rregullta. Për sa i takon, a po ndalemi rekomandim pas rekomandimi.

Valdete Daka: Ndoshta kishte me qenë më mirë që të vendoset për rekomandim.

Betim Gjoshi: Kryetare a bënë nëse më lejohet. Nuk është problem tek mënyra si procedojmë, se ne nuk kemi ndokund vërejtje i japim rekomandim, çka është e mira se ne duhet të japim transparencë për publikun edhe është mirë që secilën prej këtyre rekomandimeve ta shoqërojmë me vendim të shkruar, p.sh. nëse numërojmë 5 kuti për këtë arsye thuhet që për këtë arsye. Se ne qoftë përballemi me kandidatët atëherë ata mund të kenë vota ta ndryshme por me subjekte politike pra e gjithë kjo është mirë të shoqërohet me draft vendimi unë e kuptoj punën e shpejt sot që ka pasur qëllim sekretariati ti lejoj qendrës së votimit me vazhduar sa më shpejt me përfunduar punë, ditëve të tjera sepse nuk do të jenë vendime e vetme besoj. E dyta për disa problematika si shiritat është numri më i madh që kemi pasur në histori të tonin si kryesi, e tretamendoj qe rekomandimet apo shpjegimet nuk janë shumë të qarta nevojiten më shumë fjalë mos t'ju dhimbsen fjalët se janë të pa qarta, siç thuhet me gjysmë fjale pa shumë folje edhe, është shumë problem të kuptohet a është e gjitha në rregull apo nuk është për mua është më mirë të ketë më shumë fjalë sepse më bënë më bindës për ta votuar.

E fundit çfarë desha të them është se, ne kem filluar skanimin e gjithë formularëve, tha z. Gjoshi. Në bazë gjitha informacioneve janë përfunduar rezultatet e partive të kandidatëve, për hir të transparencës unë kisha kërkuar mi publiku nëse keni mundësi teknike se nuk e di në formën q fare janë si imazhe që janë skanuar, a janë të publikuara është mirë që pas një kontrole se mos keni harruar diçka është mirë ti publikoni që ti ketë publiku sidomos subjekti dhe kandidatët që

janë në garë. Unë sa i përket rekomandimit të parë nuk kamë ndonjë problem vetëm thash që edhe këtu mungon qartësia, këtu thuhet se në disa vendvotime kanë gjetur që materialet kanë qenë në rregull, nuk kemi ndonjë fjali a është gjetur libri i votimit apo nuk është gjetur që është shumë me rëndësi e mandej materialet e tjera siç e tha me gojë kryeshefi që ishte më kuptimplotë se kjo që është e shkruar, për ndryshe votoj për.

Adnan Rrustemi: Së pari e vlerësoj si të dobishme punën që ka bërë QNR-ja për skanimin e FRK-ve dhe FRP-ve, mendoj që edhe rrit transparencën edhe garanton funksionimin e QNR-së sikurse garanton edhe integritetin e rezultateve ose ua jep mundësin palëve për ta monitoruar këtë gjë. Pajtohem që të publikohen pa dyshim, ato janë dokumente që do të duhet ti kishin në dispozicion vëzhguesit dhe komisionarët që në vendvotim por për fat të keq dhe për arsye teknike nuk kanë mbërritur të realizohen. Unë do të doja që të ishte sot koordinatori i QNR-së këtu dhe ti them disa pyetje që nuk e di krye shefi a do të mbërrinte të përgjigjej, por do ti parashtroj këtu në hyrje thotë mungoj lista përfundimtare e votuesve ndërsa kur lexoj secilën kategori nuk ka që mungon lista përfundimtare e votuesve. Nuk e di a e kanë bërë këtë si sfond të mundësive që kutit munden të shkojnë në karantinë për cilat sillet rekomandim, apo bëhet fjalë për rast konkret të hasur në këto kuti.

Nëse bëhet fjalë për rast konkret, tha Rrustemi, nuk është asnjë vendvotim në raportin e prezantuar që mungon lista përfundimtare e votuesve. Padyshim që do të ishte mirë që të kemi informacione më tepër për këto vendvotime e sidomos informacion ose vlerësim më të zgjeruar për këtë kategori nga QNR-ja, në rastin e parë po e zëmë natyrisht që unë pajtohem me rekomandimin sepse libri i votimit në të gjithë e dimë që vlera dhe pesha e ati si dokument rritet ose theksohet kur ka ankesa për ecuri në atë votim, për ndryshe është një lloj pasqyrimi i mbarëvajtjes nga këndvështrimi kryesuesit por nuk ndikon në vlerësimin e rezultateve të një vendvotimi për sa kohë që ka përputhje në mes të FPR-së në rastin konkret në mesë nënshkrimeve, fletëvotimeve të përdorura të vlefshme etj. Por ka mundur ky të jap sqarime një rekomandim, vlerësim pak më të gjerë që në këto vendvotime përkundër që mungon libri i votimit është bërë përpjekje që të gjenden ose është gjetur në to dhe jo këto të tjerat por pjesa tjetër është komplet në rregull ka përputhje e kështu me radhë. Kamë edhe rekomandime të tjera por po shkojmë me pjesë për secilën pastaj.

Valdete Daka: Të shkojmë me rend për secilën rekomandim për derisa i kemi ashtu të ndara. Atëherë rekomandimi për grupin e parë pra për 5 vendvotime është që të procedohen si të rregullta meçen se QNR ka gjetur se çdo gjë është në rregull. Kush është për...?

Faleminderit, a ka kundër...? Jo....vazhdojmë me kategorinë e dytë....!

Enis Halimi: Kategoria e dytë ka të bëjë me problemet me shiritat të cilat i keni të listuar në faqen 3-4-5 dhe një pjesë e faqes 6. Gjatë pranimit të materialit në QNR, për shkaqe të pa rregullsive me shiritat një numër i madhe i vendvotimeve janë dërguar në karantinë, arsyeja pse kanë shkuar në karantinë është sepse në KKZ nuk ka pasur arsyetime të mjaftueshme në raportin e pranimit, ka pasur një vërejtje dhe ca gabime në paketim të materialit kemi hasur më shumë nënshkrime në listën e votave me kusht sesa zarfe, libri i votimit brenda kutisë pra janë disa raste kur janë futur, po ashtu lista përfundimtare ka qenë e future brenda kutisë. Gjatë hetimit sipas

procedurave nuk është vërejtur ndonjë parregullsi në gjitha këto rastet që janë cekur dhe duke qenë kështu pra mbi bazën e këtij analizimi dhe hulumtimi QNR-ja rekomandon komisionin që këto votime të procedohen si të rregullta duke qenë se është evidente që sado që kanë ndonjë mungesë teknike materiali në kuptimin substancial të fjalës është në rregull.

Valdete Daka: Faleminderit, atëherë kush është që 135 kuti të cilat janë të listuar.

Adnan Rrustemi: Më falni dy fjalë shkurt për këtë kategori. Po jam dakord edhe unë me gjithë sele ta theksojmë mbase në raportet e ardhshme, që këto janë disa nën kategori megjithatë po e quajmë nuk janë të njëjta si rasti më parë, diku ka problem me gabime teknike diku ka gabime me paketim ndryshim të shiritave dhe diku ka më shumë zarfe se nënshkrime dhe raste tjera më shumë nënshkrime se zarfe për fletëvotimet, për votimin me kusht. Unë jam dakord por, unë jam i bindur që në dokumentet që i ka nxjerrë QNR-ja ka arsyetime për këto dhe është mirë që me na përcjell pse duhet anëtarët e KQZ-së në këtë rast të votohet për rekomandimin e QNR-së kanë më shumë informacion se sa që kanë prezantuar, dhe prapë po e theksoj mbase e thamë që të njoftohen subjektet politike sidomos për numërimet që do ti kemi më pas që të kemi mundësi me afate të caktuara me orë të saktë kur fillon rinumërimi që të ketë mundësi ta vëzhgojnë në kapacitete të plota që operon QNR-ja në rastet e rinumëtimeve.

Valdete Daka: Faleminderit, pra kush është për që 135 vendvotime të listuar siç i keni në material të procedohen si të rregullta.

Betim Gjoshi: Kryetare nëse më lejon veç para se të marrim vendim se për jam sepse nuk po dua të diskutojë. Por ka disa të shpjegime që mund të mungojnë p.sh. thuhet që janë dy zarfe thatë janë dy nënshkrime më shumë janë më pakë, disa raste në përpara votat me kusht i kemi anuluar edhe është mirë që të jenë më të qarta, unë thash që janë anuluar ku nuk përputhen nënshkrimet me zarfe me kusht nuk kemi si të vazhdojmë më tutje është njësoj si mos të kemi përputhje të pjesa tjetër, është mirë ti shikojmë se ndoshta në terminologji keni gabuar se në qoftë se rekomandimi nuk përputhet me nënshkrimin në rubrikë këtë po ju them. Faleminderit.

Valdete Daka: Atëherë edhe njëherë, kush është për që këto kuti të procedohen si të rregullta? Faleminderit.

Betim Gjoshi: Ose është gabuar, e këto kanë qenë arsytet pse janë hapur kutia dhe janë ndërruar shiritat arsytimi mungon qose thuhet ka më shumë nënshkrime sesa zarfe dhe nuk thuhet sa është gabim në qoftë se në rekomandojmë ta procedojmë si të rregullt se prapë sistemi nuk e lejon të shkohet më tutje. Unë po mendoj që arsytet dhe pse janë ndërruar shiritat ka qenë këto gabimet në paketim kanë qenë këto, unë po ju them që shikon edhe një here këto, përmirësoni me të dhëna kur i bëni vendimet e shkruara.

Valdete Daka: Sepse në fund e kemi edhe kategorinë ku nuk kemi përputhjen e zarfeve dhe listën e votuesve me kusht, e kemi edhe një kategori edhe ku propozohet. Atëherë vazhdojmë me kategorinë e tretë.

Enis Halimi: Kategoria e tretë ka të bëjë me formularët e rezultateve që nuk janë nënshkruar nga anëtarët e këshillit të vendvotimit. Janë 3 raste gjithsej në 3 komuna të ndryshme, është evidentuar që mungojnë këto nënshkrime KVV-ve, dhe pas hetimit është vërejtur që nuk ka asnjë

parregullsi dhe si të tilla mund të rinumërohen, pra është rekomandimi nga qendra që këto vendvotime të rinumërohen.

Valdete Daka: Pra megjithëse QNR-ja ka gjetur se nuk ka ndonjë parregullsi ka rekomanduar që këto vendvotime të rinumërohen.

Adnan Rrustemi: Po është e domosdoshme të rinumërohen më genes nuk janë vërtetuar rezultatet nga komisionarët. Unë pajtohem se duhet të rinumërohen të shihet gjendja në kuti, megjithatë kishte mundur QNR-ja në librat e votimit të këtyre vendvotimeve ndonjë mendim të shprehur ndonjë vërejtje mbase mund edhe ta gjeni ndonjë arsyetim dhe është mirë, aty janë librat e votimit. Unë në parim pajtohem që të rinumërohen të shihet gjendja e tyre dhe ne njëfarë mënyre të konstatohen nga QNR-ja.

Betim Gjoshi: A bën kryetare. Unë nuk pata kohë shumë, se ne raportin 45min para se të filloj mbledhja e pranuar. U mundova ta analizoj te kjo kategori që janë vendvotimet e komunitetit jo shumicë, por pa marrë parasysh këtë unë mendoj që nuk ka të bëjë vetëm me rinumërimin kjo është pak më shumë në qoftë se libra e votimit komisionarët nuk kanë pranuar ta nënshkruajnë, në qoftes ka pasur pa kënaqësi lidhje me mbarëvajtje procesit atëherë duhet të shikohen më gjatë se rinumërimi nuk i zgjidhë këto probleme, mundemi me marrë si fazë të parë numërimin po më tutje është mirë të shikohen nënshkrimet të shikohen gjitha materialet e ndjeshme për me, se nuk është nënshkrimi i komisionarëve thjesht veç me vërtetu rezultat por me vërtetu një proces që ka ndodhur në ditën e zgjedhjeve.

Adnan Rrustemi: Mund ta pasqyroj libri i votimit, le ta shohim ndoshta ka hapësire për prokurori gjithmonë keni parasysh. Sa për aspektin e rezultateve po pajtohem që të rinumërohen.

Betim Gjoshi: Edhe nuk e kemi të qartë cilët formular nuk i kanë nënshkruar, a nuk janë shkruar FRK-të apo FRP-të edhe këto të qarta nuk i kemi. Unë ju thash ju kanë munguar fjalët nuk po dua të hy në çdo detaj.

Valdete Daka: Formularët e rezultateve nuk janë nënshkruar.

BinakVishaj: Mundemi me pyetur një raport për këto 3 vendvotime që pas rinumërimit me bo edhe një raport për KQZ-në për të parë a ka pasur parregullsi tjera, përderisa nuk mungojnë nënshkrime e KVV-ve. Pasi janë 3, janë pak ashtu kanë për tu hapur për rinumërim për pjesën tjetër.

Valdete Daka: Atëherë kush është që këto kuti të rinumërohen? Faleminderit. Shkojmë me kategorinë e katërt.

Enis Halimi: Faleminderit. Kategoria e katërt ka të bëjë me mungesat e rezultateve të formularëve të kandidatëve, janë 2 vendvotime ne 2 komuna të ndryshme. Gjatë pranimit të materialit është evidentuar se mungon FRK, pas hetimit nuk është gjetur FRK brenda kutisë dhe rekomandohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të marrë vendim që këto vendvotime të rinumërohen.

Valdete Daka: Nëse nuk kemi pyetje, kush është që këto 2 kuti të rinumërohen. Faleminderit, vazhdojmë me kategorinë e pestë.

Enis Halimi: Kategoria e pestë ka të bëjë me formularët e rezultateve të kandidatëve, pra rastet kur formularët e rezultateve të kandidatëve janë ta pa plotësuar, i kemi gjithsej 12 raste të tilla kur në pranim është evidentuar se FRK-ja është e pa plotësuar. Dhe pas hetimit është evidentuar se tek votimi 18-30E01R mungon edhe libri i votimit, rekomandojmë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të marrë vendim për rinumërim të këtyre kutive

Valdete Daka: A ka dikush pyetje. Nëse jo kush është që këto 12 kuti të rinumërohen? Faleminderit. Shkojmë me kategorinë e gjashtë.

Enis Halimi: Kategoria e gjashtë ka të bëjë me formularët e rezultateve pjesërisht, por jo tërësisht është e plotësuar formulari dhe edhe për këtë rekomandojmë që këto vendvotime gjithsej 13 të rinumërohen.

Valdete Daka: Kush është për që këto kuti të rinumërohen? Faleminderit. Kemi edhe kategorinë e shtatë.

Enis Halimi: Kategoria e shtatë ka të bëjë me mospërputhjen e zarfeve të fletëvotimeve me kusht, me listën e votuesve me kusht i kemi gjithsej 19 raste me komuna të ndryshme. Gjatë pranimit është evidentuar se tek thesi i zarfeve të fletëvotimit me kusht në disa raste ka më shumë zarfe të fletëvotimeve me kusht se nënshkrime në listën e vendvotimeve me kusht në rastet e tjera janë se mungojnë zarfet e sigurisë, mungojnë zarfet e fletëvotimit me kusht edhe pse janë nënshkrimet në listën e votave me kusht dhe rast tjetër kur janë shënuar votuesit me kusht në librin e votimit pa nënshkrime të cilët nuk janë të regjistruar në librin e votimit me kusht. Rekomandohet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që këto vota me kusht të këtyre kategorive të refuzohen si të tilla.

Valdete Daka: Atëherë e kemi rekomandimin që këto vota me kusht...

Adnan Rrustemi: A bënë një pyetje konkrete të ja bëjë kryeshefit? Mesa po kuptoj, nëse i referohem tekstit të rekomandimit për mua është e qartë, por dua të sigurohem nëse këto vendvotime janë të dyfishta apo vota të rregullta si vota me kusht dhe rekomandimi është që të anulohen vetëm votat me kusht. Që të sigurohem që vota e fletëvotimeve të rregullta të këtyre vendvotimeve të refuzohen.

Valdete Daka: Atëherë kush është që këto vota me kusht të këtyre kategorive të refuzohen? Faleminderit, a ka kundër?

Betim Gjoshi: Kryetare edhe terminologjia këtu në fund ishte e pa rregulluar me fjalët tuaja që të anulohen se refuzim nuk ka si kategori. ka mendoj është me rëndësi që të paktën këto 23 kuti, që e morëm 3 kategorive 27 apo sa ishin që morëm vendim ti rinumërojmë për këto është mirë që sa më 13 edhe 12 barabartë 25, 30 kuti që morëm ti rinumërojmë për këto të jenë vendimet sa më shpejtë. Në faqen jo vetëm për njoftim të vëzhguesve por në të ardhmen kur kemi, kanë ndonjë ankesë kandidatët për këto vendvotime se kemi pasur në të kaluarën të dimë që janë rinumëruar edhe është si rezultat i rinumërimit.

Adnan Rrustemi: A mundem shkurt, dy fjalë. Po të informohemi edhe ne se kur ndodhë rinumërimi sepse, brenda mundësive mundemi të përcjellim, siç u tha në fillim të këtij raporti bëhet fjalë për mos përputhje në fazën e pranimit se ka raste të ngjashme dhe tjera që janë identifikuar kur ka mos përputhje mes FRP-ve dhe FRK-ve. Ka disa subjekte që kanë adresuar edhe ankesa në BZAP dhe mendoj që parimi i njëjtë duhet të vlejë edhe në këto raste, unë kam bindjen që do të detektojnë në fazën e më vonshme kur futen të dhënat por duhet të rinumërohen disa vendvotime të tjera, ku kandidatët kanë vota por nuk kanë shënuar te vota e subjektit politik me FPR-në. Faleminderit.

Betim Gjoshi: Kryetare nëse më lejon. Ne e dimë gjithë që sistemi tek ne i detekton këto rastet kur p.sh. kandidatët thamë më herët ka vota. Nuk janë rinumërimet e fundit me një fjalë do të ketë rinumërim sipas gjitha gjasave se për ndryshe unë kisha pasur t'i adresoj disa vendvotime të cilat i kamë parë vetë që nuk janë bartur të dhënat si duhet nga fleta e punës, formularët kryesor ose kur partive kanë harruar t'ju vendosen votat e subjekteve. Po një prej tyre p.sh është në Gjakovë 0232C02D ka 100 e ca vota subjektet politike është vetëm totali i subjekteve politike nuk iu është ndarë subjektit ndërsa kandidatët e subjekteve kanë, i kamë parë vet edhe në atë pjesën e skanuar ka edhe disa raste kur ju kanë ngatërruar ju është lëvizë prej një rubrike në një rubrikë, sidomos ato partitë që i kanë pasur afër me numra kanë vendosur por gjitha këto besoj që kandidatët i hedhin që jo, ne në fund e gëzojmë të drejtën që të vendosim për rinumërimin e tyre se tashmë i kemi të skanuara dhe i kemi parë vet ka pasur mundësi mi shikuar shumicën e komunave ti analizojmë dhe kamë gjetur kesi raste pa marr parasysh për cilin subjekt bëhet fjalë. Kështu që kryetare ndoshta para përfundimit të rezultateve në fund nëse nuk janë objekt i Evidentimit të Qendrave të Numërimit është mirë ti shikojmë ne.

Valdete Daka: Kjo kishte me qenë e tëra me siguri që sa i përket rinumërimit i cili besoj që do të filloj sot, në qoftë se nuk e kam gabim me siguri që vëzhguesit e subjekteve politike do të informohen, apo ndoshta edhe janë informuar.

Enis Halimi: Vazhdimisht ju përcjellim informata edhe te vëzhguesit për orarin, por edhe një here po ju them që qendra edhe duke punuar pa ndërprerje 24 orë, është e hapur duke ju mundësuar transparencë maksimale çdo pale të interesuar për gjitha fazat edhe të skanimit, edhe të procedimit të materialit të pranimit por edhe numërimit dhe rinumërimit kështu me radhë.

Valdete Daka:Faleminderit, nëse nuk kemi pyetje tjera mbledhja u krye...faleminderit...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
